



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 20 paragrafi 11, të Ligjit Nr. 06/L-024 të trajtimin e ndërtimeve pa leje “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 14/2018”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-184 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2023”, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (d), lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, -----, miraton këtë;

Projekt-V E N D I M

Neni 1

1.1 Me këtë vendim **LIROHEN** nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje të gjitha gratë dhe të gjithë aplikuesit që aplikojnë për legalizimin e ndërtimit në bashkëpronësi të burrit dhe gruas. Me qëllim të fuqizimit të gruas në pronë dhe ngritjes së vetdijësimit për regjistrim të pronës së përbashkët, njëherit ndikimit të rritjes së numrit të aplikuesëve në këtë proces.

1.2 Lirimi nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje bëhet vetëm për kategorinë e I (parë) që janë shtëpi dhe kategorinë e II (dytë) që janë shtëpi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N S Ë N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI